



Dh. Mehmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 731, datë 16.9.2020

P Ë R

PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR
NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES
SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT NË BASHKITË KURBIN, LEZHË
DHE Durrës

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 191 253 259 lekë (njëqind e nëntëdhjetë e një milionë e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Durrës.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2020, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi prej 49 633 459 (dyzet e nëntë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.

- b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi prej 65 164 800 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e shembjeve të objekteve të pabanueshme të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre.
- c) Bashkisë Durrës i transferohet fondi prej 76 455 000 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e procesit të transportit të materialeve të dala nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Kurbin, Lezhë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4513/1
DATË 12.9. 2020

MINISTRIT TË SHETITË PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE KURBIN, LEZHË DHE DURRËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

